

SHOQERIA TREGTARE
Me pergjegjesi të kufizuar

"FREKLO" shpk
Lezhë

AKT THEMELIMI

Ne Tirane , sot me daten 20/01/2022 une i nenshkruari :

1-Klodian Zotaj, datelindja 10/06/1987, lindur në Fierzë dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me nr ID I70610075L

Me Vullnet të lire të plotë, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur :

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
Ne baze te Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare"
dhe Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 me ndryshimet " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit "
krijojmë shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, "FREKLO" shpk Lezhë, Shqipëri.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga Ortaku I sipercituar, me emrin "FREKLO" shpk Lezhë, emertimi i të cilit do të jete i stampuar dhe ne vulën e saj.

NENI 2


Selia e shoqerise "FREKLO" shpk është:
Adresa Mali Rrencit, zona kadastrale nr.2568, nr. pasurie 1073/18, Lezhë, Shqipëri.

NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikes së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit.

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, mund të krijohen ose anulohen, seli, filiale, agjensi dhe perfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si Degë apo perfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.



1

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) lekë, formuar dhe nënshkruar nga ortaku i vetëm , e përbërë nga 1 kuotë me vlerë 100 000 (njëqind mijë)lekë , dhe do të shlyhet mbasi shoqëria të jetë rregjistruar në QKR dhe i përket ortakëve të mësipërm në përpjesëtimin e meposhtëm :

Z. Klodian Zotaj, me 100.000 (njëqind mijë) lekë duke zoteruar 100% të kuotave

Shoqëria përgjigjet për humbjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 10 vjet.
Me vendim të Asamblese se Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim QKR për të bërë shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 6

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikës se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor.

Shoqëria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo t'u behen të ditura.

NENI 8

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e shërbimeve në fushën e hoteleri turizmit, akomodime, bar, restorant, beach-bar, plazh privat, sipërmarrje investimesh, menaxhim pronash & pasurish si edhe cdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

NENI 9

Me vendim të Asamblesesë Ortakeve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për përmbajtjen e shoqërisë.

NENI 10

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 11

Asambleja e Ortakeve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i njeh asambleesë së ortakëve.

Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoj kompetencat një ose me shumë administratorëve të caktuar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 12

Administrator i shoqërisë "FREKLO" shpk, është

1- Klodian Zotaj, datelindja 10/06/1987, lindur në Fierzë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me nr ID I70610075L

I cili është zgjedhur në këtë pozicion për një periudhë pesë vjeçare me të drejtë rinovimi.

NENI 13

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, të cilat nënshkruhen prej ortakut në çdo faqe.

THEMELUESIT E SHOQËRISË TREGTARE

"FREKLO" SHPK
Klodian Zotaj